

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i

## Fjalimit të Xhumasë

të Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

## Hazret Mirza Masrur Ahmedit

mbajtur në Bad-Kreuznach të

Gjermanisë më

# 21 maj 2004

Kalifati

**H**azuri e filloi fjalimin e tij me recitimin e ajetit 56 të sures An-Nuur të Kuranit të shenjtë dhe vazhdoi duke thënë se përkthimi i këtij ajeti është: **"Atyre, nga mesi i juaj, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u premtun se do t'i bëjë kalifë (zëvendës) në tokë, ashtu siç i kishte bërë kalifë (zëvendës) ata që ishin para tyre; dhe do ta forcojë fenë e tyre, të cilën e ka zgjedhur për ta dhe frikën e tyre do ta zëvendësojë me paqe dhe siguri. Ata do të më adhurojnë vetëm Mua dhe nuk do të më shoqërojnë askënd. Ata të cilët edhe pas kësaj do të më refuzojnë, ata vërtetë janë njerëz të ligj".**

Allahu Ta'ala, në këtë ajet, u ka premtuar kalifatin myslimanëve, por, për përmbushjen e këtij premtimi Ai i ka vënë edhe disa kushte, dhe vetëm nëse do të përmbushen ato kushte, vetëm atëherë kalifati do të vazhdojë.

Fatkeqësisht, në periudhën e hershme të Islamit, kalifati rashidah (kalifati i vërtetë) vazhdoi vetëm për 30 vjet. Gjatë vjetëve të fundit të kalifatit, aktivitete djallëzore dhe intriga u thurën kundër kalifëve, madje disa prej tyre edhe i vranë; dhe kalifati rashidah (i vërtetë) mori fund, për t'u zëvendësuar më pas me mbretëri. 1300 vjet të Islamizmit kaluan në një gjendje të këtillë pa kalifë të vërtetë dhe myslimanët u qeverisën nga mbretër, shpesh jo të drejtë dhe mizor. Kjo është një temë tjetër dhe unë nuk dua të futem në këtë temë, por atë që dua ta përmendë këtu është se, çfarëdo premtimi që Zoti i ka dhënë Muhamedit s.a.s. dhe çfarëdo që Profeti i Shenjtë ka profetizuar, i bazuar në revelatë, është plotësuar ose do të plotësohet. Njëra nga ato profeci ishte edhe ardhja e Mesihut të Premtuar dhe vazhdimësia e kalifatit të tij. Ky sistem i kalifatit, sipas premtimeve të Allahut do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit.

Transmetohet nga Hazret Huzeifa, Allahu qoftë i kënaqur me të, se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë, s.a.s. duke thënë se: **"Profetizmi do të jetë me ju për aq gjatë sa të dëshirojë Allahu; pastaj Ai do ta vendosë Kalifatin, si zëvendës të Profetit. Pastaj ky kalifat do të pasohet nga mbretëri jo të drejta; dhe njerëzit nuk do të jenë të lumtur nën to".** Sipas disa haditheve të tjera, me kalimin e kohës, gjendja do të vijë vetëm duke u keqësuar, derisa mëshira e Allahut do të zgjohet, dhe atëherë, Allahu do t'i japë fund asaj periudhe dhe pastaj kalifati përsëri do të rifillojë dhe pastaj thuhet se Profeti s.a.s. nuk tha asgjë më tutje.

Ne jemi fatlumë që jemi dëshmitarë të plotësimit të kësaj profecie në ditët tona dhe jemi dëshmitarë të këtij kalifati që do të vazhdojë. Në fakt, ne jemi ata që

kemi besuar në Mesihun e Premtuar dhe jemi duke përfituar nga bekimet e këtij kalifati.

Transmetohet në një hadith se Profeti i shenjtë s.a.s. ka thënë se: "Pasuesit e mi janë njerëz të bekuar. Është vështirë të thuhet se a është periudha fillestare e umetit tim më e mirë, apo periudha e fundit, sepse të dy këto periudha do të jenë të madhërishme. Në një rast tjetër, Profeti i Shenjtë s.a.s. e shpjegoi se çka donte të thoshte me *"periudhën e fundit"* apo me *"kohët e vona"*.

Hazret Ebu Hurreira transmeton se njëherë ne ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut s.a.s., kur iu zbrit Sureja Al Xhuma. Kur e recitoi ajetin **'Va aahariina minhum lammaa jalhakuubihim'**, që do të thotë se *"Janë disa njerëz që do të lindin në kohët e vona dhe do t'ju bashkëngjiten shokëve të mi; që ende nuk u janë bashkangjitur"*. Dikush e pyeti të Dërguarin e Allahut se kush ishin këta njerëz që e kanë këtë status të sahabëve dhe që ende nuk u janë bashkangjitur atyre? Profeti s.a.s. nuk u përgjigj para se ai njeri ta përsëriste pyetjen e tij tri herë. Hazret Selman Farsi, që ishte persian, rrinte ulur në mesin e tyre. Profeti i Shenjtë s.a.s. e vuri dorën e tij mbi supin e Selman Farsit dhe tha se: *"Edhe nëse besimi do të zhduket nga toka dhe do të ngrihet në yje, disa nga pasardhësit e tij do ta zbresin atë përsëri në tokë"*. Pra, bëhej fjalë për ardhjen e Mesihut të Premtuar që do të vinte në *"kohët e vona"* dhe ata që do t'i besojnë atij do ta kenë statusin e sahabëve të Profetit. Falënderojmë Allahun që na ka mundësuar të lindim në këtë kohë dhe na ka mundësuar që të besojmë në Mesihun e Premtuar dhe Imam Mehdiun, a.s. Sipas këtyre profecive, kalifati i bazuar në profetizëm do të rivendosej edhe një herë. Kalifati i Mesihut të Premtuar nuk do të jetë i përkohshëm, por do të vazhdojë deri në fund të botës.

Mesihu i Premtuar, a.s. ka thënë: *"Allahu i manifeston dy lloje fuqish. Së pari Ai e shfaq fuqinë përmes Profetit. Pas vdekjes së Profetit, besimtarët ballafaqohen me vështirësi dhe armiqtë krekosen dhe mendojnë se besimtarët së shpejti do të shpërndahen dhe shkatërrohen, e madje edhe vetë besimtarët fillojnë të dyshojnë dhe e humbasin shpresën dhe disa prej tyre e lëshojnë edhe besimin. Pastaj Allahu e manifeston fuqinë e Tij të dytë dhe e mbron Xhematin e Tij; dhe ata që shfaqin durim deri në fund e shohin këtë mrekulli. Ashtu siç kishte ndodhur në kohën e Hazret Ebu Bekrit, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur njerëzit menduan se vdekja e Profetit ishte e parakohshme dhe disa nga pasuesit e rëndësishëm e lëshuan besimin; atëherë Allahu e ngriti H. Ebu Bakrin dhe e shfaqti fuqinë e Tij të Madhe dhe e mbrojti Islamin dhe e plotësoi premtimin e Tij, i cili thotë se: "Frikën do ta zëvendësojmë me paqe". E njëjta kishte ndodhur edhe në kohën e H. Musait a.s. Përshkruhet në Tevratë se kur vdiq Hazret Musai u bë shumë vaj, dhe për katërdhjetë ditë besimtarët qanë dhe vajtuan. Ngjashëm, edhe në kohën e Isait a.s. kur të gjithë dishepujt ia kishin kthyer shpinën, dhe njëri prej tyre e kishte braktisur besimin"*.

Mesihu i Premtuar thotë më tutje: *"Pra, o miq, kjo është praktika e Allahut prej kur ekziston njerëzimi dhe Ai nuk do ta ndryshojë këtë praktikë të Tij. Pra, ju nuk duhet të pikëlloheni e as të merakoseni, sepse është e domosdoshme për ju që ta shihni manifestimin e fuqisë së dytë; dhe kjo është mirë për ju, sepse ky manifestim i fuqisë së dytë është i përhershëm dhe do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit. Fuqia e dytë nuk do të manifestohet derisa të mos shkoj unë, dhe kur të shkoj unë, Allahu do ta dërgojë atë **fuqi** të dytë te ju e cila do të vazhdojë të jetë me ju; ashtu siç ju ka premtuar Allahu në "Burahine Ahmedia" (profeci në njërën nga librat e Mesihut të Premtuar). Është premtim Hyjnor për ata që bëjnë vepra të mira, se do ta kenë kalifatin. Ky premtim nuk është për mua, por është për ju; siç thuhet: "Atyre që të pasojnë ty, Unë do t'u jap fitore kundër jobesimtarëve deri në Ditën e Gjykimit". Pra është e domosdoshme që të shihni ditën e largimit tim nga kjo botë, që të mund ta shijoni përmbushjen e premtimit të Allahut, sepse Zoti ynë*

*është Besnik dhe Ai do t'i përmbushë të gjitha ato premtime që ua ka dhënë. Ka shumë vështirësi që do të vijë dhe kjo është e nevojshme, por botës nuk do t'i vjen fundi deri sa të mos plotësohen të gjitha premtimet, që Allahu jua ka dhënë. Unë jam ngritur si Fuqi e Allahut dhe jam Fuqi e personifikuar e Allahut; dhe do të ketë të tjerë pas meje që do ta manifestojnë fuqinë e dytë. Pasuesit e mi nga të gjitha vendet duhet vazhdimisht të lutën që kjo fuqi e dytë të zbres nga Qielli. Unë u them se Allahu është i Fuqishëm dhe do të ju mbrojë dhe ndihmojë juve. Njerëzit e mirë duhet të futen në Xhematin tim. Allahu dëshiron që të gjithë njerëzit e dëlirë që jetojnë në vende të ndryshme të botës, duhet të mblidhen në një fe të vetme; dhe ky është qëllimi i dërgimit tim në botë”.*

Mesihut i Premtuar a.s. na ka dhënë lajmin e gëzueshëm se: *"Allahu ka premtuar se ky kalifat do të vazhdojë, dhe armiku kurrë nuk do të përjetojë dy gëzime (njëri kur të dëgjojnë për vdekjen e Mesihut të Premtuar a.s.). Ata kurrë nuk do ta përjetojnë gëzimin e dytë e të shohin rënien e Xhematit tim”.* Armiku ishte tepër i gëzuar, thotë Kalifi, kur dëgjoji për vdekjen e Mesihut të Premtuar, por, premtimi i Allahut se do ta zëvendësojë frikën e besimtarëve me paqe, u përmbush; dhe Xhemati zgjodhi Hazret Hakim Nurudin për Kalif të Parë. Ai ishte në moshë të shtyrë dhe me shëndet të lig. Kjo i bëri armiqtë të shpresonin se vështirë që ai do të mund ta udhëhiqte Xhematin. Disa nga Anxhuman (organ qeverisës brenda Xhematit, menjëherë pas Kalifit) menduan se do të ishin në gjendje të bënin çka të donin, duke menduar se Kalifi, për shkak të moshës së tij të shtyrë, nuk do të ishte në gjendje t'i kuptonte planet e tyre. Por Allahu i asgjësoi komplotet e tyre të liga. Allahu asgjësoi çdo komplot të brendshëm ose të jashtëm dhe e largoi çdo rrezik që i kanosej Xhematit të Tij. Jemi dëshmitarë se Kalifi i Parë i Mesihut të Premtuar, Hazret Hakim Nurudin Sahib, r.a. i luftoi me sukses ato intriga dhe i shkatërroi. Ai thoshte se:

*"Pasi që zgjedhja e Kalifit nuk bëhet nga njerëzit, inteligjenca e njeriut nuk mund ta dijë se cili njeri zotëron më shumë aftësi udhëheqëse. Allahu ka premtuar:*

***'VaadaLlahul-ladhina aamanu minkum va amilussaalihati***

***ajastakhlifanahum fil ardh'*** *(U ka premtuar Allahu atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira se do t'i bëjë zëvendës (kalifë) në tokë.), se puna e caktimit të Kalifit është punë e Allahut. Ai thoshte se asnjë njeri apo Anxhuman nuk më ka bërë mua Kalif, e as që mendoj se ndonjë Anxhuman ka fuqi të caktojë ndonjë kalif, as që do ta konsideroja caktimin e tyre; dhe nëse do të më braktisin s'do të bëhesha aspak merak; e as që ka fuqi dikush ta marrë Kalifatin nga unë. Ata thonë (Anxhuman) se detyra e Kalifit është të udhëheqë namazet dhe të pranojë bejtet. Një hoxhë mund ta bëjë këtë. Unë po ju them se, tani e tutje ju nuk do të mund të lëvizni asnjë centimetër nga urdhri i Kalifit”.*

Pastaj me fjalimet e tjera dhe me veprimet që mori kundër "Anxhuman"-it, të cilët po bënin shumë zhurmë, arriti t'i nënshtrohte; por ata edhe më tutje u munduan të shfrytëzonin çdo rast të volitshëm për të krijuar çrregullime, por kurrë nuk arritën ndonjë sukses në planet e tyre.

Pas vdekjes së Kalifit të Parë, të njëjtit njerëz e ngritën përsëri kokën dhe u munduan të krijonin çrregullime në Xhematë dhe në njëfarë mase arritën të siguronin mbështetjen e disave në Xhematë. Ata e dinin se nëse do të lejonin që të zgjidhet ndonjë Kalif, ai do të ishte Bashirudin Mahmud Ahmed. Kalifi i dytë r.a. u tha atyre se unë nuk kam ndonjë dëshirë të bëhem Kalif dhe jam i gatshëm t'i nënshtrohëm kujt do që do të votohej nga shumica. Por, ata ishin kundër zgjedhjes së çfarëdo Kalifi, sepse e dinin se nëse ndonjë Kalif do të zgjidhet, njerëzit sigurisht do ta votonin Mirza Bashirudin Mahmudin r.a. dhe vazhdimisht insistonin duke thënë se kalifi nuk duhet të zgjidhet menjëherë por duhet të presim për disa muaj. Xhemati nuk ishte i gatshëm ta pranonte një propozim të tillë, sepse Xhemati dëshironte të mblidhej nën një dorë dhe më në fund e zgjodhi për Kalif të Dytë

Hazret Mirza Bashirudin Mahmud Ahmadin dhe bëri bejtin në dorën e tij. Madje edhe pas kësaj, kundërshtarët menduan se pasi që dijetarët janë me ne, e edhe paratë janë nën kontrollin tonë, ata nuk mund të mbijetojnë gjatë, por Allahu e shfaqti edhe një herë mëshirën e Tij dhe e zëvendësoi gjendjen e frikës me paqe dhe i asgjësoi të gjitha shpresat e armiqtë dhe i shkatërroi planet e tyre.

Pastaj gjatë Kalifatit të dytë më 1934 komplete dhe intriga të reja ngritën kokë, por Allahu i shtypi dhe askush nuk mundi ta lëndonte Xhematin. Pastaj kishte trazira më 1953, pas krijimit të Pakistanit kur opozitarët tanë menduan se tani që kemi krijuar shtetin tonë, Pakistanin, tani duhet të ndërmarim masa kundër Xhematit Ahmedia që t'i japim fund njëherë e përgjithmonë. Përsëri, Allahu me mëshirën e Tij, e nxori Xhematin nga kjo situatë e vështirë dhe bota e pa se, jo Xhemati por armiqtë e tij u shkatërruan, ndërsa Xhemati Ahmedia u ngrit me një madhësi të re dhe vazhdoi të rritej dhe të përparojë.

Kalifi i Dytë qëndroi në postin e Kalifit për 52 vjet me radhë dhe Xhemati gjatë kohës së tij njohu vetëm suksese. Përktimi i Kuranit të shenjtë u bë në shumë gjuhë të botës, shumë misione u themeluan në vende të ndryshme të botës, etj. Ai personalisht ishte i involvuar në të gjitha sferat, sepse në atë kohë ende nuk ishin themeluar departamentet e ndryshme që kemi sot, dhe ai direkt u jepte udhëzime dhe këshilla misionarëve që e çuan para këtë përparim, jo vetëm në Indi e Pakistan, por edhe në shumë vende të ndryshme të botës. Pastaj mund ta shihni se si e ndërtoi strukturën administrative të xhematit. "*Sader Anxhuman Ahmedia*" ekzistonte edhe më parë, por ai bëri ndryshime në të në mënyrë që ai të merrej me punët e veta dhe të mos paraqiste ndonjë rrezik për Kalifatin. Pastaj krijimi i organizatave ndihmëse si: "*Ansarullah*" (organizata e veteranëve), "*Khudamul Ahmedia*" (organizata e të rinjve) dhe "*Laxhna Imailah*" (organizata e garave). Ai e organizoi Xhematin në atë mënyrë që çdo sektor ta kuptojë përgjegjësinë e vet se ata janë të cilët duhet ta mbështesin Xhematin dhe të bëjnë ndryshime pozitive në vetën e tyre. Nëse ky ndërgjegjësim krijohet në një komunitet, atëherë askush nuk mund ta dëmtojë një komunitet të tillë. Tani këto organizata ndihmëse janë themeluar në të gjitha vendet ku Xhemati është prezent dhe është aktiv.

Sot, "*Khudamul Ahmedia*" në Gjermani është duke e mbajtur Ixhtemanë e tyre. (tubimin vjetor) . Pastaj ai e themeloi "*Tahrike Xhedidin*" (sektori për predikim jashtë Indisë dhe Pakistanit) . Në kohën kur armiqtë e Xhematit rrihnin gjoks se tani ne do ta zhbëjmë Kadijanin, Kalifi i Dytë e themeloi *Tahrike Xhedidin* dhe si rezultat misionet u themeluan në vende të ndryshme të botës. Edhe sektori i "*Vakfe Xhedid*"-it, që në fillim ishte i destinuar vetëm për predikim në Indi dhe Pakistan, tani është shpërndarë në tërë botën. Aq shumë punë është bërë nga ai njeri, i cili në sytë e këtyre 'intelektualëve' (të Anxhumanit) të Xhematit ishte vetëm një fëmijë i papjekur (fjala është për Kalifin e dytë që u zgjodh si Kalif në moshën 25 vjeç). Por i njëjti fëmijë krijoi një revolucion të madh në botë dhe përmbushi premtimin e Mesihut të Premtuar të cilit Allahu i kishte dhënë në revelatën e njohur '*Unë (Allahu) do ta çoj mesazhin tënd në skajet e fundit të botës*'.

Kur Allahu e zgjedh një kalif, Ai i merr parasysht të gjitha aspektet. Është e mundur që një njëri të jetë më i aftë në një lëmi të diturisë, por kur zgjidhet drejtori i një shkolle, për shembull, nuk kihet parasysht vetëm se a është mësues i mirë ose a ka kualifikim të lartë; sepse ai i cili duhet ta udhëheqë administratën dhe të punojë me ata që janë nën të, duhet të ketë edhe shumë kualitete të tjera. Ngjashëm, edhe personi i cili do të caktohet Kalif shikohet nga të gjitha kualitetet. Në fillim u caktua Hazret Ebu Bakri. Kishte shumë njerëz të tjerë të aftë. Por, nuk mund të bëhet kalif ai i cili mendon se është më i kualifikuar se të tjerët. Khalid Bin Valid kishte pushtuar mijëra njerëz; Hazret Umeri nuk kishte arritur fitore të tilla në

luftë, por si Kalif ishte zgjedhur Umeri. Në kohën e Hazret Osmanit, kishte sahabë shumë të aftë. Disa kishin kualifikime të ndryshme e disa të tjerë kishin ngadhënyer në beteja të shumta në gjithë botën, por Kalif ishte zgjedhur Hazret Osmani.

Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar ka thënë: *"Në rastin e zgjedhjes së Kalifit, vendimi i shumicës do të pranohet. Dhe kush kundërshton do të jetë nga rebelët. Sa herë që vjen koha për zgjedhje, atij që zgjidhet si Kalif, unë i jap lajmin e mirë se Allahu do ta mbrojë dhe mbështes dhe kushdo që ngrihet kundër tij, qoftë i madh ose i vogël, do të shkatërrohet dhe turpërohet".*

Pas vdekjes së Kalifit të Dytë, u zgjodh Kalifi i III-të i Mesihut të Premtuar. Çka ndodhi atëherë? A pati ndonjë rënie në Xhematë? Jo, përkundrazi Allahu sipas premtimeve të Tij, i hapi dyert e përparimit edhe më shumë se më parë. Numri i misioneve në vende të ndryshme të botës u rrit. Gjatë turneut të tij në Afrikë ai hapi disa shkolla dhe spitale për t'i shërbyer popullit të varfër të Afrikës. Shumë njerëz gjetën shërim në spitalet tona. Madje edhe njerëz të pasur ose nëpunës qeverie vijnë në spitalet tona. Pse? Sepse mjekët tanë e kryejnë detyrën e tyre me ndërgjegje dhe pasion dhe gjithashtu janë të ndihmuar nga lutjet e Kalifit të kohës. Për ta vendosur nderin e Kalifit të Tij, Allahu i pranon lutjet e tyre. Ai që shërben me pasion, duke e ditur se është duke i shërbyer çështjes së fesë dhe duke qenë i sigurt se është i mbështetur nga lutjet e Kalifit, ai do të ketë suksese të mëdha në trajtimin e pacientëve.

Ministri i energjisë së Ganës është shkolluar në shkollën ahmediane. Ai pastaj shkoi te një shkollë tjetër që gjithashtu ishte shkollë ahmediane dhe sot Allahu i ka dhënë atij pozitë të lartë. Ka edhe shumë njerëz të tjerë, dhe nëse i vizitoni vendet e Afrikës do t'i shihni të gjitha këto bekime. Doktorë ose mësues, të gjithë janë duke punuar me pasion të madh duke u nisur nga parimi se gjithçka që bëjnë ta fillojnë me lutje duke i kërkuar bekimet e Allahut dhe gjithashtu duke kërkuar prej Kalifit të kohës që të lutet për ta. Shkollat dhe kolegjet në Afrikë, me ndihmën e Allahut, janë bërë gjithashtu një mjet predikimi. Një grua, me fëmijët e saj, erdhi dje nga Sierra Leone. Gjatë bisedës, ajo tha se familja jonë nuk dinte asgjë rreth Islamit para se unë të regjistroheshja në shkollën Alhmediane. Ajo ishte një grua e sinqertë. Ka qindra mijëra të tjerë, që pasi janë edukuar në shkollat tona e kanë pranuar Islamit dhe janë futur në Xhemat dhe janë duke përfituar nga këto bekime.

Më 1974, gjatë kohës së Kalifit të tretë, armiqtë e Xhematit krijuan shumë probleme dhe ishin të bindur se kësaj here Xhemati Ahmedia do të shkatërrohet. Ata menduan se duke i deklaruar ahmedianët si jomuslimanë, fundi i tyre do të vije shumë shpejt. Cili ishte përfundimi? Shumë ahmedianë ranë dëshmorë, pronat dhe pasuritë e tyre u përdhosën, shtëpitë, dyqanet dhe fabrikat e tyre u dogjën. Çka ndodhi? A ishte ky fundi i Ahmediatit? Jo, Ahmediati vetëm sa përparoi edhe më shumë dhe u rrit. Biri u vra në sy të të atit dhe i ati në sy të të birit; por a e braktisën ahmedianët ahmediatin? Jo, vetëm sa u forcuan në besimin e tyre dhe u lidhën edhe më fortë me Xhematin dhe planet e tyre kurrë nuk u plotësuan. Allahu ua ka kompensuar vuajtjet e tyre me bekime të shumta. Ata do të shpërblehen në botën e pastajme, por edhe në këtë botë ju ka dhënë shpërblim i madh shpirtëror dhe material. Allahu i ka bekuar pa masë bizneset e tyre. Juve që jeni këtu në Gjermani, Allahu ju ka dhënë mundësi të vijnë, sepse kishte opozitë në Pakistan. Dhe kur e krahasoni gjendjen tuaj të tanishme me atë të kaluarën, sa shumë diferencë të madhe që ka dhe sa shumë ju ka bekuar Allahu dhe ju ka dhënë pasuri. Kjo kërkon që ju të përujeni para Allahut edhe më shumë dhe ta adhuroni Atë edhe më shumë, dhe ta kultivoni të njëjtën ndjenjë edhe te pasardhësit tuaj,

sepse çfarëdo bekimi që keni, e gjithë kjo është si rezultat i vështirësive që keni përjetuar në Pakistan; dhe tani jeni në komfort.

Pastaj erdhi koha e Kalifit të Katërt. Gjatë Kalifatit të Katërt, armiku përsëri u mundua të krijonte shqetësime dhe probleme për Xhematin, por Xhemati vazhdoi përpara me përparimin e tij. Allahu edhe një herë e shndërroi gjendjen e frikës në paqe. Pas përafërsisht dy viteve, kur armiqtë e panë se intrigat e tyre po dështonin, ata bënë një plan tjetër dhe filluan të përdornin një taktikë tjetër, dhe kjo ishte që ta shndërronin Kalifin në një gjymtyrë të pa jetë që të mos mund të bënte asgjë, dhe nëse Kalifi nuk do të mund të funksiononte, Xhemati do të dobësohej, do të ndahej dhe përfundimisht do të shkatërrohej. Por, Allahu e bëri planin e Kalifit të ngadhënjente mbi planet e tyre. Allahu i hapi rrugën Kalifit të Katërt të emigronte nga Pakistani. Askush nuk mund të pohojë se ai e bëri këtë fshehurazi. Ai haptazi doli dhe në pikë të ditës fluturoi nga aeroporti i Karaqit. U munduan ta ndalnin, por Allahu i kishte mbuluar sytë e tyre dhe nuk mundën ta njihnin. Çfarë argumenti tjetër do të kërkojë dikush për vërtetësinë e Ahmediatit. Kur Profeti i Shenjtë s.a.s. emigroi prej Mekës, armiqtë e Islamit iu vunë pas, por Allahu e shpëtoi. Ngjashëm ndodhi edhe me Kalifin tonë dhe Allahu e mbrojti në të njëjtën mënyrë; dhe besimi ynë u forcua edhe më shumë. Kur arriti në Perëndim, ai e forcoi Xhematin dhe aktivitetet u zgjeruan shumë, ndërsa njerëzit filluan të futeshin në Xhematë në qindra-mijëra dhe miliona. Pastaj MTA-ja (Muslim Television Ahmediyya) u themelua. Qeveria e Pakistanit kishte bërë plane që ta shurdhonte zërin e Kalifit, por me anë të MTA-së ai zë u shpërnda në gjithë botën dhe të gjitha intrigat dhe planet e kundërshtarëve u asgjësuan. Fjalimet e tija më parë dëgjoheshin vetëm në Rabvah, e tani zëri i tij po arrin në çdo qytet e katund dhe në çdo familje përmes satelitit. Pastaj aktivitetet humanitare u zgjeruan shumë në vende të ndryshme, e sidomos në Afrikë. Shkurt, kjo ishte një kohë e një përparimi të madh. Çdo ditë e re sillte me vete përparime të reja. Nganjëherë njeriu mendon se ky është kulmi dhe s'ka ku vete më tutje, por Allahu bën gjëra që njeriu nuk mund t'i imagjinojë.

Pas vdekjes së tij, armiqtë edhe njëherë shpresuan se tani Xhemati Ahmedia do të dobësohet dhe do të marrë fund, sepse nuk po shihnin askënd që do të mund ta zëvendësonte Kalifin e IV-të dhe të kujdesej për Xhematin. Por, edhe një herë të gjithë e panë manifestimin e fuqisë së Allahut. I madh e i vogël, burra dhe gra i kanë parë këto pamje të ndihmës dhe mbështetjes së Allahut, të cilat ua kanë forcur besimin. Edhe joahmedianët, myslimanë e jomyslimanë i kanë parë këto pamje nëpërmjet MTA-së. Në Londër dikush më tha se: "*kemi qenë të mahnitur me sistemin tuaj dhe zgjedhjen e Kalifit të ri*". Edhe në Pakistan i kanë parë ato pamje. Një pacient që kishte shkuar te Dr. Nuri (një anëtar i Xhematit) dhe që ishte dijetar i madh i fesë, tha se e kishte përcjell në televizor zgjedhjen e Kalifit të ri dhe kishte thënë se kanë qenë pamje mahnitëse. Doktorin i tha: "*Atëherë, pra, duhet ta pranosh se Ahmediati është i vërtetë*". Ai tha se: "*Unë ende nuk mund të them se Ahmediati është i vërtetë por vetëm mund të them se Allahu është duke ju mbështetur dhe ndihmuar*". Pra, thotë Kalifi, nëse Allahu është duke na ndihmuar, për çfarë argumenti tjetër po presin ata.

Tani Allahu e ka zgjedhur për Kalif një njeri, që nëse vështrohet nga syri materialist, njerëzit as nuk do t'ia lëshonin sytë. Por te Allahu nuk çon peshë popullariteti i njerëzve. Mesihu i Premtuar, a.s. ka thënë: "*Mbani mend se Allahu e cakton kalifin dhe e përgënjeshton atë i cili thotë se kalifi caktohet prej njerëzve*". Prandaj Kalifi i Parë, Hazret Molvi Nurudin e theksonte vazhdimisht se Kalifi caktohet nga Zoti dhe jo nga njerëzit. Nëse studiohet hollësisht Kurani i Shenjtë, njeriu e sheh se caktimi i Kalifit nuk është punë e njeriut porse për secilin Kalif Allahu thotë se Ne të kemi ngritur ty si Kalif. Pastaj Kalifi i Parë thoshte se Ai i cili e

cakton Kalifin, Ai i jep atij edhe aftësitë e nevojshme. Edhe qoftë injorant, Allahu i jep atij dituri. Kjo do të thotë se sa herë që Allahu e cakton ndonjë Kalif, Ai ia jep atij atributet e Tij. Nëse nuk ia jep këto kualitete, atëherë, çfarë kuptimi ka pohimi se Allahu e cakton Vetë Kalifin.

Allahu më njeh mua më mirë se ç'e njoh unë veten time, por, unë i di paaftësitë e mia, dhe e di sa pak kam, por në secilin moment ia përkujtoj vetes Fuqinë e Allahut. Një poet ahmedian ka thënë në një poezi të tij se: "**Zoti im është i mjaftueshëm për mua**". Ai po i referohej unazës së Mesihut të Premtuar në të cilën është e shkruar revelata "**Aleisall-llahu bikaafin 'abdahuu'**" që do të thotë: "Vallë, a s'është Zoti i mjaftueshëm për robin e vet?" dhe që pas vdekjes së tij ka kaluar prej njërit Kalif në tjetrin. Hazuri thotë se Mesihut të Premtuar a.s. ka pasur edhe tri unaza të tjera që u ishin lënë fëmijëve të tij. Njëra unazë në të cilën ishte shënuar revelata '**Maula bas'** (Zoti im është i mjaftueshëm) i ishte dhënë Mirza Sherif Ahmedit, gjyshit tim dhe pas vdekjes së tij i ishte dhënë babait tim dhe pas vdekjes së tij më është dhënë mua. Unë e kam ruajtur me kujdes dhe nuk e kam përdorur, por pas zgjedhjes sime si Kalif fillova ta bart. Kur e shikoj veten time e shoh të parëndësishëm. Allahu e ka mbjellë dashurinë për Kalifin e kohës në zemrat e njerëzve. S'ka njeri që do të mund të krijonte një dashuri të tillë. Kundërshtarët kanë bërë shumë zhurmë dhe kanë folur shumë, por le të bëjnë zhurmë sa të dëshirojnë, dhe le të përpiqen sa të munden, por, s'do të mund të bëjnë gjë, se Kalifati na është dhënë prej Allahut dhe do të jetë me ne sa të dëshirojë Allahu.

Kur isha në Afrikë, kohët e fundit, njerëz që kurrë nuk më kishin parë, shfaqën një dashuri të paparë për Kalifin e kohës. Çka është gjithë kjo? Çka ishte gjithë ai gëzim që shihej në fytyrat e tyre? Kishin hequr të zitë e ullirit për të arritur deri aty nga krahina të largëta. A ishte kjo vetëm për t'u treguar para dikujt? Ata kishin ardhur nga vise të largëta për të më takuar, të shtyrë nga dashuria për Kalifatin. Dashurinë që Allahu e krijon në zemrat e dikujt, askush nuk mund ta shkatërrojë, pa marrë parasysh sa shumë mundohet. Kam parë njerëzit duke derdhur lot dashurie. Të gjitha këto janë argumente që e mbështesin të vërtetën e Ahmediatit; nëse dikush ka sy për të parë. Nëse disa njerëz e lëshojnë Xhematin, ose flasin me hipokrizi, s'prish punë, secili korrë ç'ka mbjellë. Nëse një shkon, Allahu i bie qindra shpirtra të çiltër në Xhematë. Duhet ta mbani mend se premtimet e Allahut janë të vërteta. Ai është duke e ndihmuar këtë Xhematë të Mesihut të Premtuar dhe Ai kurrë nuk do të na braktisë; e përsëris, kurrë nuk do të na braktisë. Allahu po vazhdon edhe sot me përmbushjen e premtimeve që ia ka bërë Mesihut të Tij, ashtu siç kishte bërë edhe në kohën e Kalifëve të mëparshëm. Ai është duke na bekuar ashtu siç na ka bekuar në të kaluarën. Dhe insha'allah, do të vazhdojë të na bekojë edhe në të ardhmen. Çka kërkohet prej nesh, është, që t'i përulemi, t'i lutemi, t'i kërkojmë bekimet e Tij dhe të rrimë të bashkuar rreth Kalifatit, atëherë askush nuk mund të ju dëmtojë as edhe vetëm një grimë. Na dhëntë mundësi Allahu të bëjmë kështu. Amin!

**Note:** This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of:

**21 May 2004** The topic of this Khutba is: '**Khilafat'**

This translation has been prepared by the members of Kosovo Jam'aat